



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/



REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

Nr. i Protokollit: 02/1044

Data: 8.9.2025

Të dashur qytetarë, Komuna e Shtimes, në kuadër të projektit “Kontrata Sociale” dhe në bashkëpunim me USAID-in, për të dytin vit radhazi ka nisur procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje.

Këtë vit, banorët e fshatit Reçak do të kenë mundësinë të vendosin vetë për mënyrën se si do të shpenzohen 25 mijë euro të ndara nga buxheti i komunës.

Ky proces synon përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje, përmes votimit të drejtpërdrejtë, ku ata do të zgjedhin projektin që duan të financohet dhe të realizohet në fshatin e tyre.

Dëgjimi publik do të mbahet në SHFMU "Skënderbeu", në Reçak, më 10.9.2025, duke filluar nga ora 19:00

Zëri yt ka rëndësi, merr pjesë dhe vendos për të ardhmen e fshatit tënd!

Ju mirëpresim!